



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**“PËRCAKTIMIN E VLERËS NË PARA TË NJË VOTE TË VLEFSHME, PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023”**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenit 88, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe të vendimit nr. 27, datë 7.8.2023, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”,

VËREJ:

Neni 88, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nxjerrja e rezultatit përfundimtar në shkallë vendi, përcakton me vendim vlerën në para të 1 (një) vote të vlefshme, duke pjesëtuar fondin e përgjithshëm të miratuar, me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, që kanë marrë jo më pak se 1 përqind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore llogaritja bëhet mbi bazën e votave të marra për këshillat vendore në shkallë vendi.

Referuar lidhjes nr. 2, të vendimit nr. 27, datë 7.8.2023, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



“Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”

2023”, partitë që kanë përfituar jo më pak se 1 përqind të votave dhe votat e vlefshme të grumbulluara prej tyre, janë si më poshtë:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	579.625 vota	43.11%
2. Bashkë Fitojmë (BF)	247.883 vota	18.44%
3. Partia Demokratike (PDSH)	103.723 vota	7.71%
4. Partia Socialdemokrate (PSD)	86.283 vota	6.42%
5. Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë (PAA)	44.047 vota	3.28%
6. Partia Republikane Shqiptare (PR)	32.071 vota	2.39%
7. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU)	28.978 vota	2.16%
8. Partia Lëvizja e Legalitetit (PLL)	23.683 vota	1.76%
9. Aleanca Progresiste L.ZH.K (LZHK)	22.906 vota	1.70%
10. Partia Demokracia Sociale (P.D.S)	21.798 vota	1.62%
11. Fryma e Re Demokratike (FRD)	18.459 vota	1.37%
12. Aleanca Liberale e Djathtë (ALD)	16.859 vota	1.25%
13. Partia e Gjelbër (P.GJ)	16.326 vota	1.21%

Gjithsej vota të vlefshme

1.242.641 vota

Fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për financimin e fushatës zgjedhore të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, referuar vendimit nr. 30/2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e fondit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023”, ishte 100,000,000 (njëqind milion) lekë.

Referuar nenit 88, pika 2, të Kodit Zgjedhor, pjesëtimi i fondit të përgjithshëm të miratuar me numrin në total të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, që kanë marrë jo më pak se 1 përqind të votave të vlefshme në shkallë vendi sjell si rezultat vlerën në para të 1 (një) vote të vlefshme 100.000.000 (njëqind milion) lekë / 1.242.641 (një milion e dyqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e dyzet e një) vota = 80.47 (≈ 81) lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 88, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe vendimin nr. 27, datë 7.8.2023, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”,

V E N D O S:

1. Vlera në para e një vote të vlefshme është 81 (tetëdhjetë e një) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI